

ANILA KANANAJ

TIPARE TË SINTAKSËS HISTORIKE TË SHQIPES

1.0. Hyrje

Objekt i këtij punimi janë elemente sintaksore të shqipes së vjetër, parë në aspektin diakronik. Në studimet tona mungon një qasje e mirëfilltë sintaksore ndaj shqipes së dëshmuar në autorët e vjetër. Elemente të shkëputura të sintaksës gjenden aty-këtu, por nuk ka studime në sistem. Fjalorët konkordancë për veprat e para ku dokumentohet shkrimi shqip nuk ndihmojnë shumë për këtë qëllim sepse ata kanë si fokus kryesor pasqyrimin e korpusit të plotë leksikor të tekstit, të shoqëruar me shembuj ilustrues në funksion të kuptimit apo të fjalëformave që hasen. Kontekstet ilustruese në këto konkordanca, duke qenë se nuk kanë në fokus të veçantë strukturën sintaksore, janë të pamjaftueshme për të ndërtuar në sistem tiparet sintaksore të shqipes në këtë periudhë. Filologjia e teksteve shqipe ofron botime kritike të teksteve të shekujve XVI – XVIII, çka përbën ndihmesë të jashtëzakonshme për studimet gramatikore.

Materialet dhe metoda

Elemente strukturore të shqipes së vjetër i kemi vjelë së pari nga vepra e Kolë Ashtës "Leksiku historik i gjuhës shqipe II: Leksiku i nxjerrë nga vepra e Lekë Matrëngës (1592)" (1998). Në fushë të studimeve historike të shqipes Kolë Ashta ka dhënë një ndihmesë të vyer veçanërisht me veprat e tij mbi leksikun historik të gjuhës shqipe. Në veprën e vet autori bashkë me shpjegimin e lemave aty ku mundet jep edhe etimologjinë e fjalës, dhe kryesorja, shembujt ilustrues jepen në dy variante, në variantin e gjetur tek autori i marrë në studim dhe në variantin paralel të shembullit në latinisht. Jo rrallë, Ashta bën krahasime edhe me përdorimin e kësaj leme në autorë të tjerë të periudhës së studiuar. Në këtë aspekt, e kemi parë veprën e prof. Kolë Ashta si një ndihmesë të vyer për studime në fushë të sintaksës historike.

Për vjelje është përdorur gjithashtu "Çeta e profetëve" e Pjetër Bogdanit, transkriptim i Anila Omarit, "Dottrina Cristiana" e Pjetër Budit, transkriptim i Gunnar Svane, si edhe botimi kritik i "Emira" të Franqisk

Anton Santorit, përgatitur nga Merita Bruci (2018). "Mbsuame e Krështerë (Dottrina cristiana)" e Lekë Matrëngës është verifikuar në punimin e Joachim Matzinger (2006).

Metoda e përdorur në këtë studim do të jetë përshkruese, analizuese dhe përqsëse. Ky punim ka qasje historike në aspektin që studion gjuhën në një periudhë të hershme të shqipes dhe sinkronik. Qasja jonë është diakronike në aspektin që krahasohen elemente të caktuara sintaksore në faza të ndryshme të shqipes. Karakteri sinkronik prek dy rrafshë Ky studim nuk ka karakter etimologjik dhe nuk e synon diçka të këtillë. Etimologjia e strukturave sintaksore do të ishte pa dyshim një objekt studimi me shumë interes për studimet e shqipes, por ky nuk është qëllimi ynë. Për këtë arsye nuk është në vëmendjen tonë rruga që ka ndjekur evolucionit fonetik ose morfologjik i formave të caktuara gjuhësore të shqipes.

Rëndësia

Studimet sintaksore në faza të ndryshme të shqipes kanë rëndësi për pasqyrimin e gjendjes së sintaksës në periudha të caktuara të zhvillimit të gjuhës, si edhe për të bërë studime krahasuese për të parë konkretisht se sa ka evoluar kjo strukturë ndër shekuj. Në këtë mënyrë mund të krijohet një ide më e qartë se në lidhje me sa dhe si ka ndryshuar sintaksa në varietetet përkatëse të shqipes.

2.0. Elemente të sintaksës së shqipes së hershme

Në këtë syth do të përshkruhen një numër tiparesh sintaksore që bien në sy menjëherë në shqipen e vjetër. Sigurisht, tiparet nuk janë vjelë në mënyrë shteruese, por janë përzgjedhur ato që janë më përfaqësuese dhe më të veçanta.

1. Folje + kryefjalë në rasën emërore të përdorur me kuptimin e rasës dhanore

Folja *gjëmoj* gjendet e përdorur në shqipen e vjetër si njëvalentëshe dhe në këtë valencë ajo merr një kuptim të veçantë: *këlthas, thërras me të madhe* drejt dikujt:

gjëmuarë: *tj* (kah ty) shërëtinjëmë **tue** *gjëmuarë* e *tu(e)* klarë

E veçanta në strukturën argumentore të kësaj foljeje të realizuar me kuptimin *thërras, bërtas drejt dikujt* = *i këlthas dikujt*, është se kryefjala e shprehur me përemër vetor në rasën emërore nuk tregon vepruesin, siç është karakteristike për këtë rasë, por personin të cilit i drejtohet një

veprim, çka është tipar karakteristik i rasës dhanore ose për sintagmat me parafjalë. E realizuar me një valencë, në shqipen e sotme kjo folje ka kuptimin *jehon, uturin, buçet* dhe nuk mund të marrë një kryefjalë të shprehur me një frymor. P.sh.: **Gjëmojnë malet. Gjëmojnë topat. Gjëmon deti.** E ilustruam me shembuj nga Budi.

*E kshtu tue baam,
ndeevonë for-tue u peenduom e tue
fshaam e **tue gjëmuom** , me të madhe
devocione e të prunjëtë me votë
m kishë shinte e me paam meshë e me* (Budi, DC, f. 64, v. 1-5)

*E të tretënë : for-**tue gjëmuom** ndë
zemërë teme jes e kujtonj atë kunorë
të helmuome ferrashit e drizashit* (Budi, DC, f. 149, v. 23-25)

Në shqipen e vjetër folja *gjëmoj* paraqet një strukturë të veçantë sintaksore, e cila shoqërohet me një kuptim gjithashtu të veçantë semantik, pra bëhet fjalë për një strukturë të veçantë argumentore e cila nuk është ruajtur në gjendjen e sotme të gjuhës.

2. Folje + emër në kallëzore me një rol semantik karakteristik për rasën dhanore

Kemi evidentuar një strukturë të veçantë argumentore të foljes, konkretisht, një folje që e realizon argumentin e vet të brendshëm me një emër në rasën kallëzore, por që semantikisht ky argument bart një rol semantik karakteristik për rasën dhanore: përfituesin e veprimit të realizuar nga folja kallëzues.

të shërbenjë *Tënëzonë* ndë këtë gjellë pra shohë e të trashëgonjë ndë tjetërët

Në këtë shembull që sjell Ashta, folja *shërbej* ka marrë si argument të brendshëm emrin *Tënëzonë*, i cili është në rasën kallëzore. Kuptimi i sintagmës *të shërbenjë Tënëzonë* është ai i një shërbimi që kryhet në favor të Tënëzotit, pra *Tënëzonë* është përfituesi i veprimit të realizuar nga folja kallëzues *shërbej*. Në shqipen e sotme kjo strukturë argumentore do të ishte:

T'i shërbente Tënëzotit...

Argumenti i brendshëm i foljes *shërbej* në shqipen e sotme është në rasën dhanore dhe shpreh përfituesin e veprimit të realizuar nga folja.

Folja *shërbenj* merr emër në kallëzore në shqipen e vjetër jo vetëm kur argumenti i saj i brendshëm i shprehur me emër në kallëzore realizohet me një frymor, por edhe kur realizohet një jofrymor siç vërejmë te Budi, DC, f. 22, v. 20-23 dhe Budi, DC, f. 74, v. 5-8.

*e qiellat , – e saa ashtu ende tjera mb atë
arrësye . Praashtu veçëse lum kush
t i shërbenjë shintinë urdhënë e ligjë
e tii e t a doe me gjithë zemërë (Budi, DC, f. 22, v. 20-23)*

*e me të madh të dashunë e të prunjëtë
me j a dhanë shintesë kishë katolike
e atyne , qi me të dërejtë arrësye
shërbenjënë ndë ta ligjë e Tinëzot ; (Budi, DC, f. 74, v. 5-8)*

Ndërkaq, argumenti i jashtëm i foljes *shërbenj* realizohet me emër në rasën emërore, p.sh.:

*E prifti mbet e j tha , se : Pa më thuo ,
se ndë qish kafshë shërbenjënë
këto ndere [oder : nderë] , oo për qish arresye janë
urdhënuom ? (Budi, DC, f. 99-100, v. 26, 1-3)*

Folja *shërbenj* ka merr si argument të jashtëm një emër në rasën emërore si në shqipen e vjetër dhe në shqipen e sotme, duke e ruajtur kështu strukturën argumentore të pandryshuar.

3. Lidhja e foljes me plotësin në rasën rrjedhore pa ndërmjetësinë e parafjalës

Në gjuhën shqipe plotësi në rasën kallëzore ose në rasën dhanore lidhet me foljen pa ndërmjetësinë e parafjalës. Ndërkaq, sot kanë mbetur vetëm pak raste të përdorimit të plotësit në rasën rrjedhore në lidhje të drejtpërdrejtë me foljen kallëzues, pra që realizohet pa ndihmën e parafjalës. Ndërkaq, një lidhje e këtillë e drejtpërdrejtë e plotësit në rasën

rrjedhore me foljen drejtuese duket tipar jo i pazakonshëm në shqipen e vjetër. Struktura argumentore e foljes në këto raste paraqitet dy sojesh: a) folje e ndjekur nga dy argumente të brendshme të realizuar përkatësisht me emër në rasën kallëzore dhe emër në rasën rrjedhore, dhe b) folje e ndjekur nga një argument i brendshëm i shprehur me një emër në rasën rrjedhore.

a) folje + emër në kallëzore + emër në rrjedhore

Në shqipen e sotme foljet që marrin si argumente të brendshme një emër në rasën kallëzore dhe një emër në rasën dhanore janë të tipit *i jap dikujt diçka, i tregoj dikujt diçka*. Ndërkaq, folje si *kthej, përkthej* e kanë strukturën *kthej diçka nga një gjuhë në një gjuhë tjetër*, pra folja *kthej, në kuptim ndryshoj*, e ka argumentin e dytë të shprehur me sintagmë parafjalore, njësoj si në strukturat lokative të tipit *lëviz, kaloj, transferoj diçka nga një vend në një vend tjetër*. Në shqipen e vjetër vërejmë një strukturë argumentore pak më ndryshe.

nkthej (=kthej): zuna fiill mund aqë saa munda, ***nktheva*** *këtë shinte Doktrinë gjuhet* (sipas Ashtës, Budi, DC, 15)

*ta mee u ndimuom feeja e Krishtit , zuna
fiill mund aqë saa munda , nktheva
këtë shinte Doktrinë gjuhet së lëtime
mbë gjuhu-t arbëneshe – si për ndimët të* (Budi, DC, f. 10-11, v. 13-16)

Te Budi dëshmohet që folja *nkthej* merr si argumente të brendshme një emër në kallëzore dhe një emër në dhanore. Emri në kallëzore si argument i brendshëm i foljes *kthej* përdoret normalisht në shqipen e sotme, pra kemi ruajtje strukture. Emri në dhanore si argument i brendshëm i foljes *kthej* përdoret në shqipen e sotme në kuptimin *i kthej dikujt diçka që i kam marrë*, pra bëhet fjalë për një kuptim tjetër dhe jo kuptimi që vumë në dukje te Budi. Në kuptimin që e përdor Budi, pra të pikëmbërritjes ose të destinacionit të veprimit, folja *nkthej* e realizon argumentin e dytë të brendshëm me një emër në dhanore, gjë që në shqipen e sotme ka ruajtur kuptimin, por sintaksorisht ka evoluar në një sintagmë parafjalore.

b) folje + emër në rrjedhore

Dallimi i rasës rrjedhore në shkrimet e autorëve të vjetër, por edhe në shqipen e sotme, paraqet vështirësi pasi në numrin njëjës të pashquar dhe të shquar tek emrat ajo del me të njëjtat mbaresa gramatikore si dhanorja. Edhe në trajtën e shquar shumës nuk ka dallim formal midis rasave dhanore dhe rrjedhore sepse mbaresa është -t për të dyja rasat (Demiraj 1985, 254). Studiuesit vendosin për përkatësinë rasore të emrit duke u nisur nga funksionet rrethore ose kundrinore që luan emri. Për këtë arsye *mishit* dhe *zemëret* në shembujt më sipër merren si emra në rasën rrjedhore.

Në numrin shumës të pashquar emri në rasën dhanore dallohet nga mbaresa -sh, p.sh. tek autorët e vjetër kemi tipin *maleshit* për rrjedhoren dhe *malevet* për dhanoren. Ndërkaq, rasa rrjedhore dallohen nga nyja *së* dhe rasa dhanore nga nyja *të* në mbiemrat e nyjshëm të gjinisë mashkullore dhe asnjansë, edhe kur këta janë të emëruar, njësoj si tek emrat prejpesorë të paranyjësuar të tipit *të folurit* (Demiraj 1985, 285). Mbështetur në këto fakte, *së këqiashit* dhe *së tjerësh* në shembujt e paraqitur janë emra në rasën rrjedhore.

të ruhesh mishit të mërkurrë e të premtënë
luntë ata ç'i janë gëzuar zemëret
të tretënë ditë u ngre së vdekurit
e keqja lirona gjithë së këqiashit
dhënë së tjerësh

Të gjithë këta plotës në rasën rrjedhore në shqipen e sotme është normale që ta realizojnë lidhjen me foljen drejtuese me ndihmën e një parafjale:

të ruhesh prej mishit
luntë ata që janë gëzuar në zemër
të tretën ditë u ngrit prej së vdekurish
na lirona prej gjithë të këqiave
dhënë nga të tjerët
dhënë të tjerëve

Ndërkaq, zëvendësimi i lidhjes së drejtpërdrejtë të plotësit me një lidhje tjetër sintaksore, konkretisht, me anë të një parafjale, është shoqëruar me ndryshime të strukturës argumentore të foljes. Në një sërë

rastesh, kur përdoret parafjala *prej* është ruajtur rasa rrjedhore, por kjo rasë nuk ruhet kur përdoret një parafjalë e një rase tjetër, ose kur plotësi e realizon rolin semantik nëpërmjet rasës dhanore.

3. Kundrina e drejtë e shprehur me emër në gjinore

Te Matrënga, kundrina e drejtë mund të shprehet edhe me një emër në rasën gjinore. Këtë dukuri e vë në dukje edhe vetë Ashta, i cili shprehet se plotësi i argumentit gjendet i ndërtuar sipas italishtes tue e vënë emrin shqip në rasën gjinore, p.sh:

kemi **thënë të të bëmevet** të mirahabbiamo **detto delle** buone opere
çë janë të bënenë; **thua**j nani **të të** che si hano a fare ditte adesso le
male
këqiavet çë kemi të ikënjëmë e përpara che si hano di fugire et prima
të të shtatë mkatëvet çë kluhe- delli sette peccati che si chia-
në se vrasënë. mano mortali (Matrënga, f. 230)

Kjo dukuri është me mjaft interes në aspektin gjuhësor, porse duhet parë në korpus në mënyrë shteruese për të parë shtrirjen dhe tipologjinë e saj, d.m.th. llojet e foljeve dhe të emrave me të cilët përdoret. Kjo do të jepte mundësi për të parë nëse autorët kanë transferta gramatikore nga italishtja, apo bëhet fjalë për një dukuri sintaksore të brendshme të shqipes së vjetër.

4. Rasa vendore, me mbaresën -t me parafjalët *ndë, ndënë, ndëpër, mbë, mbi, me, përmbi, për*

Emrat në rasën vendore, të realizuar me mbaresën -t dhe me parafjalët *ndë, ndënë, ndëpër, mbë, mbi, me, përmbi, për*, janë një dukuri e njohur e shqipes së vjetër.

ishtë **ndrë** qiellt;
hipi **drë** qiellt; të hipuritë e tij **drë** qiellt;
kle gjeturë **ndë** klishët e **ndë** mest të urtëvet; të këqijt **ndë** pisët;
vdiq **ndë** kriqt; Përforcoj **ndë** nomt të vjetër e pastaj Krishti
Tinëzot i mbajti **ndë** të rīt; tue vënë dorënë... **ndë** ballët; pastaj...
venë **ndë** parraisit;
të didaksnë vangjeljë **për ndë** gjithë kosmit;
tue vënë dorënë... **ndënë** krahët të djathëtë e të shtëmënkëtë; tue
vënë dorënë... **ndënë** krahëruart;

mbahenë... mbë të mësuesit të krështerë; jemi bërë mbë shëmëllit e të glarë të tij; të rahuritë mbë kulonët; mbë ndeljesët të mkatevet; të shtatë (urdhërimet tjera) prepsnjënë mbë diafuart të fqinjësë;

mbt gjithë shërbiset;

s kanë shrëbliere gjithë qish për mkatët (e) tire; që pistepën ti për besët?

kā të jētë nderturë me zëmëret; të vënëtë të kurorësë me kurorët glinbash; kā të jētë nderturë për para me zëmëret, pra me gluhët.

Në shqipen e sotme, rasa vendore thuhet ka humbur. Gjurmë të saj gjenden në ndonjë të folme toske të shqipes, por në pjesën më të madhe të saj nuk përdoret më.

5. Parafjala mbë/ndë + emër i pashquar + emër i shquar në gjinore

Nëse një emër ndiqet nga një emër tjetër në rasën gjinore, kjo e bën emrin paraprijës të jetë në trajtën e shquar. Shquarsia e emrit paraprijës vjen si rrjedhojë semantike, pasi emri në gjinore e individualizon emrin paraprijës, pra e dallon atë nga bashkësia e gjerë e emrave përkatës. Kjo është rregulla që vepron në shqipen e sotme. Është interesante që në shqipen e vjetër gjejmë shembuj kur kjo rregull nuk zbatohet. Gjejmë raste të sintagmave parafjalore të tipit parafjala mbë/ndë + emër i pashquar + emër i shquar në gjinore:

të bājturitë të kriqës mbë rait të kalvarit (rait = rraht)

kloftë ardhurë ndë vjet të apolipsit

Emri në gjinore do të duhej ta bënte emrin paraprijës në trajtë të shquar, e megjithatë një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Kjo mund të shpjegohet me drejtimin e fortë të parafjalës. Është normale në shqipen e sotme që parafjalët e rasës kallëzore të ndiqen nga një emër në trajtë të pashquar, gjithashtu në rasën kallëzore. Vërejmë që në shqipen e vjetër drejtimi i parafjalës në rasën kallëzore është aq i fortë, sa emri që e plotëson atë ruan trajtën e pashquar edhe kur ndiqet nga një emër në rasën gjinore. Në këtë rast, rregulla sintaksore ka marrë përparësi në krahasim me rregullën semantike.

6. Folja ndihmëse *mund* e ndjekur menjëherë nga folja që bart kuptimin leksikor të konstruktit modal

Konstrukti me foljen modale *mund* ndodh të ndiqet menjëherë nga folja me kuptim të plotë leksikor në dialektin gegë në shqipen e vjetër dhe në shqipen e sotme. Kjo dukuri nuk vërehet më sot në dialektin toskë sepse lidhja e foljes *mund* me foljet që e ndjek, bëhet me anë të pjesës së *të* të lidhjes. Në veprat e autorëve arbëreshë vërehet se folja modale *mund* ndiqet menjëherë nga folja me kuptim të plotë leksikor, pa ndërmjetësinë e pjesës së *të* të lidhjes. Autorët arbëreshë kronologjikisht i përkasin shekullit XIX, por dëshmojnë gjithësi tipare të fazave më të vjetra të shqipes. Konkretisht, te Emira e Santorit folja *mund* ndiqet rregullisht nga një folje me kuptim të plotë leksikor. P.sh.:

*Janë mote valleshi këto? Së **mund vemi** të
mbjedhëmi një shkarp te mali, se
vjenë baniti e na xheshën e na tur-
pronë. Së **mund mbrëndemi** të
marrëmi një gobaçe tek Farni-
ti, se përpyekmi banitin që na tur-
pronë e na vret. Së **mund lëmi**
shtëpinë të vetëme një kred, se ve-
te kallonjeri e na e qëronë. Një vashëz
së **mund verë** më te kroi, ndomos
me prikull të dal je virgjërë, e të
priret grua gjims e shqerrurë! (Emira, f. 111)*

*Moj kush e dī si vate ajo
psuome, e ka **mund ketë** rrëvuorë shkën-
dila? (Emira, f. 127)*

*Të keqat që **mund bënë** njeriu
nënk janë si ara të shprishura kë-
tu e këtje, mbal faqen e të dheut,
kuazi palaca të ohistëra e gjel-
bullore, e **mund jenë** të para, e të vrej-
tura ka gjith pri s'afëri, e prë së
llargu. (Emira, f. 127)*

*Të jetërat që ja-
në për jashta, **mund kenë qënë**
bëra ndë zëmërë të natjes; (Emira, f. 127)*

*Çë **mund xëmi** na ndë kto pushtje-
re, ku së shohmi faqe njeriu? (Emira, f. 139)*

Madje folja ndihmëse *mund* lidhet me një folje me kuptim të plotë leksikor që paraprihet nga një trajtë e shkurtër dhe përsëri lidhja midis dy foljeve bëhet me pranëvënie pa ndihmën e pjesës *të* të lidhore. P.sh.:

*Moj mbë serpos nënk rrëvuo-
më të xëjim si, e ka **mund na vinjin**. (Emira, f. 131)*

*U që n'ahiena
së **mund e shoh** fare, megjithse
prindit i duonë aq mirë. (Emira, f. 82)*

Sigurisht, menjëherë pas foljes *mund* mund të përdoret edhe një folje në lidhore, çka është normë për toskërishten. Në këto raste, folja *mund* dëshmohet e zgjedhuar si një folje me kuptim të plotë leksikore, çka dëshmohet nga mbaresat vetore përkatëse. Ndërkaq, si folje modale ajo përdoret e ngurosur, pra në formën *mund*, dhe ndiqet drejtpërdrejt nga folja me kuptim të plotë leksikor. P.sh.:

*Dhia më kish parë
e m'u qas, po mua më kish arrunu-
rë dridhëma: s' **munda të thërritnja**
jo ntihme shëjteshi, jo njerzçi. (Emira, f. 79)*

*Këto mistere së **mundi**
t'i përhapij Shënjëti Davidh, e trituri
ti Sallamunë e **mund i përhapinjë**
u? (Emira, f. 135)*

Te Matrënga vërehet se folja *mund* pasohet nga një folje me kuptim të plotë leksikor e cila mund të paraprihet ose jo nga pjesëza *të* e lidhore. Folja *mund* te Matrënga gjendet në formën *mëndë*.

*Im. ishtë ai që bëri e qerisn
dhënë e qiellë e gjithë zotëron.
M. pse thuhetë Inëzot i fuqishim?
Im. pse me një të vetëmë vlemë të
tij e fuqī të pā sosme mēndë
bēnjë e të zbēnjë gjithë qish (Matrënga, f. 186)*

Etimologjia e foljes *mund* sqarohet në detaje nga B. Demiraj (1997: 281-282), argument që e rimerr edhe Matzinger (2006:187-188), por siç e sqaruar që në hyrje të punimit, aspekti etimologjik është jashtë vëmendjes së këtij punimi. Ne na intereson të interpretojmë sintaksorisht rendin e fjalëve, ashtu siç dëshmohet i shkruar në shqipen e vjetër.

7. Mbiemër + emër

Rendi normal në shqipen e sotme është emër i ndjekur nga mbiemri që e përcakton atë. Mund të ndodhë që mbiemri të dalë para emrit, por në këto raste mbiemri merr mbaresat rasore të emrit. Në shqipen e vjetër vërejmë një fazë të pastabilizuar të lidhjes dhe topikës që realizon mbiemri në lidhje me emrin që përcakton. Mbiemri mund të dalë para emrit në të njëjtën formë morfologjike që realizon pas emrit:

kluhenë di të mbëdhenj mistirie

Mbiemri mund të dalë para emrit duke marrë mbaresa rasore të emrit, ashtu siç ndodh edhe në shqipen e sotme:

*i dijtë shërbes (=shërbesa e dytë), të dijtënë herë (herën e dytë)
çë shembull më jep ti kaha shejta triadë*

Dukuri të këtilla dëshmojnë për një fazë më të hershme të shqipes, në të cilën lidhja emër - mbiemër ka pasur rregulla të ndryshme sintaksore nga ato që njohim sot.

8. Emër + mbiemër pa nyjë të përparme

Është karakteristikë e shqipes që mbiemri e realizon përshtatjen me emrin që e drejton me anë të nyjës së përparme, dhe/ose me anë të mbarsës fundore të mbiemrit. Në shqipen e vjetër vërehet lidhje e

mbiemrit me emrin drejtues pa ndërmjetësinë e nyjës së përparme të mbiemrit:

*kanë klënë klishë te **shpirtit shejt*** (kanë qenë kohë të shpirtit të shenjtë)

*mos bësh **bë rerë*** (mos bëj be të rreme)

Në shqipen e sotme mungesa e nyjes do ta bënte ndërtimin jogramatikor:

*kanë qenë kohë të Shpirtit Shenjtë

*mos bëj be rerë (rreme)

Prania e nyjës së përparme të mbiemrit paraqitet një rregull e domosdoshme sintaksore sot:

kanë qenë kohë të Shpirtit **të** Shenjtë

*mos bëj be **të** rerë (rreme)

Është e qartë që në shqipen e vjetër kanë vepruar rregulla sintaksore karakteristike për periudhën në fjalë.

Përfundime

Në këtë punim u përqendruam në disa tipare të veçanta sintaksore që vihen re në shqipen e vjetër. Konkretisht, vumë në dukje dhe analizuar këto tipare: 1. Folje + kryefjalë në rasën emërore të përdorur me kuptimin e rasës dhanore; 2. Folje + emër në kallëzore me një rol semantik karakteristik për rasën dhanore; 3. Lidhja e foljes me plotësin në rasën rrjedhore pa ndërmjetësinë e parafjalës (a. folje + emër në kallëzore + emër në rrjedhore; b. folje + emër në rrjedhore); 4. Kundra e drejtë e shprehur me emër në gjinore; 5. Rasa vendore, me mbaresën -t me parafjalët *ndë, ndënë, ndëpër, mbë, mbi, me, përmbi, për*; 6. Parafjala *mbë/ndë + emër i pashquar + emër i shquar në gjinore*; 7. Folja ndihmëse *mund* e ndjekur menjëherë nga folja që bart kuptimin leksikor të konstruktit modal; 7. Mbiemër + emër; 8. Emër + mbiemër pa nyjë të përparme. Të gjitha këto konstrukte sintaksore u ilustruan me shembuj nga shqipja e vjetër dhe u krahasuan me shqipen e sotme. Aty ku ishte e mundur, u dhanë shpjegime se pse këto konstrukte shfaqen në këtë formë dhe jo si në shqipen e sotme. Për të analizuar dhe shpjeguar në mënyrë të plotë këto dukuri, si dhe

dukuri të tjera sintaksore që nuk janë përmendur në këtë studim, nevojitet një studim i thelluar i korpusit të shqipes së vjetër. Punimi nxjerr në pah nevojën për studime sintaksore të shqipes së vjetër. Theksojmë se bëhet fjalë për një fushë të parrahur të studimeve të shqipes, hulumtimi i së cilës do të rezultonte në radhë të parë në një sintaksë të shqipes së vjetër.

BIBLIOGRAFI

- Ashta, K. 1998. *Leksiku Historik i Gjuhës Shqipe II: Leksiku i Nxjerrë Nga Vepra e Lekë Matrëngës (1592)*. Tiranë.
- Bokshi, B. 1980. *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. Prishtinë.
- Sauku Bruci, M. (ed.) 2018. *Emira*. Franqisk Anton Santori. Rrugëtimi i tekstit letrar dhe botim kritik i varianteve dorëshkrim në arbërishte. Tiranë: ASA, Botimet albanologjike.
- Demiraj, B. 1997. *Albanische etymologien*. Leiden studies in Indo-european 7. Amsterdam-Atlanta GA: Rodopi.
- Demiraj, Sh. 1985. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: UT.
- Dhemiraj, Sh. 1985. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: UT.
- Kostallari, A. (ed.) 1980. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. (FGJSSH)
- Matzinger, J. 2006. *Der Altalbanische Text Mbsuame e Krështerë (Dottrina cristiana) des Lekë Matrënga von 1592. Eine Einführung in die albanische Sprachwissenschaft*. Dettelbach, Germany: Verlag J.H. Röhl GmbH.
- Omari, A. 2017. *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Omari, A. (ed.) 2005. *Cuneus Prophetarum de Christo Salvatore Mundi et eius evangelica veritate - Çeta e profetëve të Krishtit shëlbuesit të botës dhe e vërteta e tij ungjillore*. Pjetër Bogdani, 1685. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Prifti, S. 1971. *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Dispensë e botuar nga universiteti i Prishtinës.
- Riza, S. 1944. *Tri monografia Albanologjike*. Tiranë.
- Rrota, J. 1942. *Syntaksa*. Shkodër.
- Rrota, J. 1942. *Analizimi i rasave t'emnit e zhvillimi historik i tynve*. Shkodër.
- Svane, G. (ed.) *Dottrina Cristiana*. Pjetër Budi, 1618.

